

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: PAKR 1123/12

Data: 27 gusht 2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarës së EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, kryetare dhe gjyqtare raportuese, gjyqtarëve Fillim Skoro dhe Xhevdet Abazi si anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e Beti Hohler, zyrtare ligjore e EULEX-it, e cila vepron në cilësinë e procesmbajtëses,

Në lëndën penale kundër

1. N.H., ..., i lindur më ... në ..., , mashkull, me vendbanim në ..., ..., ..., ..., me gjendje të mesme ekonomike, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar i Kosovës, me numër të letërnjoftimit ..., *dhe*

2. L. R., ..., i lindur më ... në ..., ..., mashkull, me vendbanim në ..., ..., ..., ..., ..., me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar i Kosovës, me numër të letërnjoftimit ...;

të akuzuar për kryerjen e veprës penale të *Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit* në bashkëkryerje, sipas nenit 339 paragrafët (1) to (3) të Kodit penal të Kosovës (KPK)¹ lidhur me nenin 23 të KPK-së;

të liruar nga vepra penale e sipërpërmendur përmes aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. P 638/2011 të datës 17.05.2012;

duke vepruar sipas ankesës së prokurorit special të paraqitur më 10.08.2012 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. P 638/2011 të datës 17.05.2012;

pas shqyrtimit të përgjigjes së prokurorit të apelit të shtetit të Kosovës nr. PPA-KTZ 465/12 të datës 27.12.2012;

pas mbajtjes të seancës së hapur më 27.08.2013 në praninë e dy të akuzuarve, avokatit mbrojtës Linn Slattengren i cili përfaqëson N. H., avokatit mbrojtës Destan Rukiqi i cili përfaqëson L. R. dhe prokurorit të apelit të shtetit Claudio Pala;

pas këshillimit dhe votimit më 27.08.2013;

¹ Kodi penal në fuqi nga data 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

në pajtueshmëri me nenet 420 dhe atyre në vazhdim të Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK)

sjell këtë:

AKTGJYKIM

I. Ankesa e prokurorit special e paraqitur më 10.08.2012 kundër aktgjykimit të (ish) Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. P 638/2011 të datës 17.05.2012 lidhur me N. H. dhe L. R., përmes këtij aktgjykimi REFUZOHET SI E PABAZUAR.

II. Dispozitivi i aktgjykimit të (ish) Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. P 638/2011 i datës 17.05.2012 NDRYSHOHET *ex officio*:

Fjala e parë e dispozitivit e cila i referohet nenit 390 paragrafi (2) të KPPK-së ndryshohet dhe thotë: “Sipas nenit 390 paragrafi (3) të KPPK-së, [...]”.

Në aktvendimin mbi shpenzimet, përmendja e nenit 103 paragrafi (3) të KPPK-së ndryshohet dhe thotë “Sipas nenit 103 paragrafi (1) të KPPK-së [...]”

III. Në të gjitha pjesët e tjera aktgjykimi i (ish) Gjykatës së Qarkut në Prishtinë nr. P 638/2011 i datës 17.05.2012, vërtetohet.

ARSYETIMI

HISTORIA E PROCEDURËS, AKTGJYKIMIT TË KUNDËRSHTUAR DHE PARASHTRESAT E PALËVE

(Historiku i procedurës)

1. Aktakuza kundër dy të akuzuarve është ngritur më 08.06.2011 në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339 paragrafi (1) deri (3) të KPK-së si edhe Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi sipas nenit 236 paragrafi (1) nën paragrafi 3) i KPK-së.

2. Gjyqtari për konfirmim të aktakuzës më 02.09.2011 nxori aktvendimin me të cilin hodhi poshtë aktakuzën. Aktvendimi pjesërisht u ndryshua sipas ankesës së prokurorit special nga kolegji i përbërë prej tre gjyqtarësh më 18.10.2011. Kolegji prej tre gjyqtarësh konfirmoi aktakuzën për veprën penale të Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit sipas nenit 339 paragrafi (1)

deri në (3) të KPK-së lidhur me dy të akuzuarit. Prandaj lënda u procedua në shqyrtimin gjyqësor vetëm për këtë vepër penale.

3. Trupi gjykues mbajti dymbëdhjetë seanca gjykimi nga data 12.01.2012 deri më 17.05.2012. Aktgjykimi u shpall më 17.05.2012. Kolegji liroi dy të akuzuarit. Kolegji konsideroi se Prokuroria nuk provoj se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën ata u akuzuan. Trupi gjykues po ashtu vendosi mbi shpenzimet në lëndë. Prokurori special paralajmëroi se do të paraqes ankesë menjëherë pas shpalljes së aktgjykimit.

4. Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim u është dërguar palëve në fund të korrikut 2012.

5. Aktgjykimi i arsyetuar me shkrim i është dërguar prokurorit special më 26.07.2012. Ai paraqiti ankesë kundër aktgjykimit më 10.08.2012.

6. Mbrojtja paraqiti përgjigjet e saj në ankesë më 23.08.2013 konkretisht më 24.08.2013.

7. Lënda u transferua nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë në Gjykatën Supreme të Kosovës (atëherë gjykatë kompetente e shkallës së dytë) më 26.09.2012. Më 01.01.2013, pas hyrjes në fuqi të Ligjit mbi gjykatat (Ligji nr. 03/L-199, tash e tutje në tekst: Ligji mbi gjykatat), lënda penale u transferua në Gjykatën e Apelit.

8. Gjykata e Apelit mbajti një seancë të hapur në lëndën penale sipas nenit 410 të KPPK-së më 27.08.2013. Të gjitha palët e edhe avokatët mbrojtës të të dy akuzuarve ishin të pranishëm në seancë.

(Aktgjykimi i kundërshtuar)

9. Trupi gjykues konstatoi se në procedurën kundër të akuzuarve dy faktet vendimtare në vijim nuk janë provuar:

- se vendimet e marra nga **L. R.** për të pranuar vazhdimin e importit të duhanit, janë bazuar në ndikim politik dhe si të tilla në kundërshtim me çfarëdo arsyesimi të shëndosh ligjor dhe

- se **N. H.** me një procedurë praktike jo të zakonshme për ..., vendosi ta zëvendësoj Besim Currin sepse frikësohej se ky i fundit do të këmbëngulte në mendimet e tij mbi ligjshmërinë e veprimeve ose sepse ai donte të zbatonte udhëzimet e dhëna nga ministri.

10. Trupi gjykues arsyetoi se interpretimi i z. **L.R.** për ndalimin e transportit në rrethana të caktuara ishte bërë i njohur shumë më parë se takimi të cilin ai e kishte me, atëherë, ministrin Ahmet Shala. Nuk ka prova se **L. R.** miratoi interpretimin ligjor për shkak të ndikimit politik. Gjithashtu nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se interpretimi i **L. R.** është “pa asnjë bazë të shëndosh ligjore”. Lidhur me mënyrën e emërimit të **L. R.** nga **N. H.**, sqarimi i sjellë nga **N. H.** është i arsyeshëm. Trupi gjykues theksoi se çdo dyshim që kishte lidhur me faktet në

lëndë, duhej të zërthehej në të mirë të të akuzuarve (*in dubio pro reo*) në përputhshmëri me ligjin.

(*Parashtrësat e palëve*)

11. Prokurori special ngrit këto arsye të ankesës: (i) shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në veçanti nenet 236, 237 paragrafi (1), 360 paragrafi (1), 360 paragrafi (5) dhe 363 paragrafi (1) të KPPK-së, (ii) vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, (iii) shkelje të ligjit penal. Ai propozon që të ndryshohet aktgjykimi i kundërshtuar duke i shpallur dy të akuzuarit fajtor sipas aktakuzës së konfirmuar ose, në mënyrë alternative, të prish aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthej lëndën në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim.

12. Në përgjigjet e saj mbrojtja kundërshton argumentet e ngritura nga prokurori special dhe shtyn gjykatën të refuzoj ankesën dhe të vërtetoj aktgjykimin e kundërshtuar.

13. Prokurori i apelit i shtetit mbështet ankesën e prokurorit special dhe shtyn Gjykatën e Apelit të prish aktgjykimin e kundërshtuar dhe të kthej lëndën në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim. Prokurori i apelit i shtetit e paraqet një mendim të hollësishëm në të cilin shtjellon arsyet e ankesës dhe përgjigjet e mbrojtjes.

GJETJET E GJYKATËS SË APELIT

I. Kompetenca e Gjykatës së Apelit

14. Gjykata e Apelit është gjykatë kompetente për të vendosur mbi ankesën sipas nenit 17 dhe nenit 18 të Ligjit mbi gjykatat.

15. Kolegji i gjykatës së Apelit është formuar në përputhshmëri me nenin 19 paragrafi (1) të Ligjit mbi gjykatat dhe nenin 3 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji nr. 03/L-053). Sipas vendimit të kryetarit të Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it nr. 2013.OPEJ.00359-0001 të datës 09.08.2013, i marrë në pajtueshmëri me nenin 3.7. të Ligjit mbi gjykatat, përzgjedhja e lëndëve dhe caktimi i lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, kolegji ishte i përbërë prej një gjyqtari të EULEX-it dhe dy gjyqtarëve kosovar të apelit.

II. Ligji procedural i zbatueshëm – KPPK-ja

16. Gjykata e Apelit e konsideron të duhur të ritheksoj se ligji procedural i aplikueshëm në lëndën penale përkatëse është Kodi i vjetër i procedurës penale i cili ishte në fuqi deri më 31.12.2012.² Në procedurat penale të iniciuara para hyrjes në fuqi të Kodit të ri të procedurës penale më 01.01.2013, e në të cilat gjykimi tanimë ka filluar por nuk ka përfunduar me vendim të formës së prerë, zbatohen dispozitat e KPPK-së derisa vendimi të marrë formën e tij të prerë. Në

² Kodi i procedurës penale të Kosovës, në fuqi nga 06.04.2004 deri më 31.12.2012.

këtë drejtim përmendet Mendimi ligjor nr. 56/2013 i Gjykatës Supreme të Kosovës, i miratuar në seancën e saj të përgjithshme më 23.01.2013.

III. Pranueshmëria e ankesës

17. Prokurori special paralajmëroi se do të paraqes ankesë në përputhshmëri me nenin 400(1) të KPPK-së më 17.05.2012, pas shpalljes së aktgjykimit.³

18. Aktgjykimi i arsyetuar i është dërguar prokurorit special më 26.07.2012. Ai paraqiti ankesë kundër aktgjykimit më 10.08.2012.

19. Ankesa është e pranueshme sipas neneve 398 paragrafi (1) të KPPK-së, 399 paragrafi (1) të KPPK-së dhe 401 paragrafi (1) të KPPK-së.

IV. Gjetjet mbi meritat e ankesës

IV. A. Shkeljet e supozuara substanciale të ligjit procedural

20. Prokurori special pohon për shkelje substanciale të procedurës penal sipas nenit 403(2) të KPPK-së. Ai parashtron se shkeljet e neneve 236, 237, 360 dhe 363 të KPPK-së kanë pasur ndikim ose kanë mundur të kenë ndikim në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të duhur.

Shkeljet e supozuara të neneve 236 dhe 237 të KPPK-së dhe shkelje e supozuar e nenit 363 paragrafi (1) të KPPK-së

21. Prokurori special argumenton se analiza ligjore e paraqitur nga **H. S.** është dashur të trajtohet si mendim i ekspertit dhe jo thjesht një provë e dokumentuar, në veçanti, sepse gjatë shqyrtimit gjyqësor z. **H. S.** ka dëshmuar në cilësinë e ekspertit. Lidhur me shkeljen e supozuar të nenit 363(1) të KPPK-së, prokurori special paraqet se është shkelur e drejta e tij që gjatë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë efektive të marrë në pyetje ekspertin sepse trupi gjykues ka lejuar vetëm pyetjet të cilat nga këndvështrimi i tij ishin të paqarta.

22. Mbrojtja paraqet se nuk ka pasur shkelje të nenit 363(1) të KPPK-së, sepse prokurori ka mundur ta marrë në pyetje dëshmitarin si ekspert gjatë shqyrtimit gjyqësor. Më tej mbrojtja mban qëndrimin e saj të miratuar gjatë shqyrtimit gjyqësor se provat e dhëna nga dëshmitari **H. S.** ishin të parëndësishme dhe dëshmitari nuk ishte i kualifikuar.

23. Qasjen e trupit gjykues lidhur me dëshminë dhe raportin me shkrim të **H. S.** i cili në atë kohë ishte këshilltar ligjor i Doganave të Kosovës, Gjykata e Apelit e konsideron konfuze dhe kontradiktore.

24. Në vazhden e hetimeve, prokurori special kërkoi nga gjyqtari i procedurës paraprake të caktoj **H. S.** si ekspert dhe të kryej analizën ligjore të ekspertit. Me aktvendimin e datës

³ Procesverbali i seancës së shqyrtimit gjyqësor, 17.05.2012, f. 2 (versioni në gjuhën angleze).

10.02.2011, gjyqtari i procedurës paraprake refuzoi këtë kërkesë. Gjyqtari i procedurës paraprake e arsyetoi këtë duke theksuar se nuk është e nevojshme asnjë urdhëresë e gjykatës për të caktuar llojin përkatës të ekspertit gjatë fazës hetimore dhe se vet prokurori special duhet të caktoj ekspertin. Asnjë ankesë nuk u ushtrua kundër këtij aktvendimi dhe më 14.02.2011 prokurori special nxori urdhëresën me të cilën caktoi **H. S.** si ekspert duke i urdhëruar atij të bëjë një analizë të pyetjeve të specifikuara në urdhëresë. **H. S.** bëri një raport të tillë dhe të njëjtin i paraqiti prokurori special më 13.05.2011. Raporti u bë pjesë e shkresave të lëndës, iu tregua me rregull mbrojtjes dhe u propozua si provë në aktakuzë.

25. Në seancën e datës 07.03.2012, trupi gjykues vendosi të dëgjojë **H. S.** në cilësinë e ekspertit.⁴ Trupi gjykues lejoi që eksperti të merret në pyetje lidhur me çështjet ligjore, duke u arsyetuar se kodi procedural nuk përmban një kufizim se çfarë lloj ekspertize mund të kërkohet nga eksperti.⁵ Prokurori special, gjithashtu, kërkoi që analiza ligjore e **H. S.** e datës 13.05.2011 të pranohet në prova si raport i ekspertit. Trupi gjykues diskutoi për statusin e dokumentit gjatë seancës më 10.02.2012. Në seancën e datës 07.03.2012 trupi gjykues vendosi mos të marrë asnjë qëndrim lidhur me statusin e analizës ligjore të **H. S.** ‘deri në këshillimin e fundit’. Trupi gjykues, duke vënë në dukje analizën me shkrim që kishte para vetës, lejoi vetëm që dëshmitarit t’i bëheshin pyetje të cilat do të qartësonin gjetjet e tij në analizën me shkrim.

26. Në aktgjykimin e kundërshtuar, trupi gjykues shtjelloi se analiza e **H. S.** sipas KPPK-së nuk mund të trajtohet si provë e ekspertit. Prandaj analiza nga trupi gjykues u konsiderua provë e zakonshme dokumentare e paraqitur nga një palë.

27. Si çështje preliminare, Gjykata e Apelit konsideron se trupi gjykues është dashur të vendos si të trajtoj analizën ligjore të **H. S.** të datës 13.05.2011 (ose si provë e ekspertit ose thjeshtë provë e dokumentuar) menjëherë pas ngritjes së kësaj çështjeje gjatë shqyrtimit gjyqësor. Trupi gjykues ka për obligim të vendos mbi propozimet e palëve sipas nenit 333 paragrafi (3) deri (5) të KPPK-së. Kolegji nuk ka pasur bazë ligjore për të shtyrë vendimin deri në këshillimin e fundit, sepse kjo, në mënyrë të qartë, do të rrëzonte qëllimin e nenit 333 paragrafi (5) të KPPK-së. Trupi gjykues medoemos duhet të vendos mbi çështjet procedurale në vazhdimësi kur ato ngrihen dhe gjithsesi para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor. Në lëndën në fjalë, Prokuroria kishte interes për të ditur nëse analiza do të konsiderohej si raport i ekspertit apo thjeshtë provë e dokumentuar me qëllim të planifikimit të strategjisë së saj. Duke vënë në pah lëshimin e trupit gjykues, Gjykata e Apelit megjithatë vëren se prokurori ishte në dijeni se deri në këshillimin e fundit nuk do të arrihej asnjë vendim mbi statusin e raportit dhe nuk ngriti ndonjë kundërshtim gjatë procedurës. Njëherazi prokurori nuk pretendon një shkelje të tillë në ankesën e tij. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit nuk ka nevojë të adresoj më tutje këtë çështje.

⁴ Sipas propozimit të parë të prokurorit, kryetari i trupit gjykues refuzoi për të dëgjuar dëshmitarin në cilësinë e ekspertit. Prokurori ankoi trupin gjykues dhe trupi gjykues ndryshoi vendimin e kryetarit të trupit gjykues, duke i lejuar tani H. S. të dëshmojë në cilësinë e ekspertit në lëndë.

⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 07.03.2012, f. 7 (versioni në gjuhën angleze).

28. Kolegji kufizoi marrjen në pyetje të ekspertit **H. S.** për të qartësuar pyetjet në analizën të cilën ai e bëri. Përgjigjet e tij prandaj ishin të kufizuara për të qartësuar çështjet nga raporti dhe vetëm këto përgjigje kishin efektin e “dëshmisë së ekspertit”. Megjithatë, si pasojë, trupi gjyqës trajtoi raportin vetëm si provë e dokumentuar. Argumentim i prokurorit duket se sugjeron atë që, po që se prokuroria do të mundte ta merrte plotësisht në pyetje dëshmitarin, ajo ndoshta do të kërkonte përgjigje të tjera nga dëshmitari. Është vënë në dukje se duke vepruar në këtë mënyrë, prokurori me përsëritjen e analizës së tij në dëshmi, do të mund të siguronte statusin e ekspertit të kësaj prove.

29. Ndërsa në vetvete kjo do të ishte një argument relevant, e njëjta nuk është vendimtare në procedurën aktuale sepse sikurse do të shtjellohet më poshtë, gjykata nuk mund të kërkojë nga ekspertet udhëzime mbi çështjet *ligjore*. Është po aq e rëndësishme që prokurori në ankesën e tij nuk specifikon se cilat pyetje konkretisht ai është penguar t’i parashtrij lidhur me këtë dëshmitar. Si vërejtje e përgjithshme, Gjykata e Apelit thekson se kur gjatë gjykimit, një palë pretendon se është penguar kundërligjshëm për të marrë në pyetje, ajo patjetër duhet të qartësojë se cila ishte linja e marrjes në pyetje dhe si ndikoi ose si do të mund të ndikonte refuzimi i kolegjit për marrje në pyetje në vendimin e formës së prerë (d.m.th të vërtetuarit e dy kushteve të kriterit të nenit 403 paragrafi (2) të KPPK-së).

30. Duke caktuar **H. S.** si ekspert, në urdhëresën e tij prokurori formuloi pyetjet në vijim: (1) *A ishin në përputhshmëri me nenin 241 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës aprovimet e ankesave të bëra nga kompanitë e duhanit Gekos, Buçaj, Tabakos dhe Kosova të cilat ishin hartuar nga z. L. R. në dhjetor 2008?* (2) *Nëse është nxjerr konkluzioni se është shkelur neni 241 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës atëherë: a ekzistojnë indikator të cilët qojnë në përfundimin se z. L. R. ishte në dijeni për zbatimin e tij të gabueshëm të nenit 241 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës?* (3) *A mban përgjegjësi ligjore drejtori gjeneral për vendimet të cilat u ndërmorën nga L. R. lidhur me pranimin e ankesave në dhjetor 2008?*

31. Rrjedhimisht del se prokuroria ka kërkuar nga **H. S.** që, nën pyetjen (1) të jap mendimin ligjor nëse vendimet e **L. R.** ishin në përputhshmëri me Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës dhe, nën (2) dhe (3) të shtjellojë elementet e përgjegjësisë (penale) të **L. R.** dhe **N. H.**

32. Sipas nenit 236 të KPPK-së me qëllim të sqarimit të çështjeve të caktuara teknike ose çështjeve të tjera profesionale, angazhohen edhe ekspertët. Kodi nuk e përcakton se çfarë konsiderohet çështje teknike ose çështje profesionale. Megjithatë në kod nënkuptohet, se gjykata nuk mund t’i paraqes për vendim një eksperti çështjet ligjore por vetëm çështjet *faktike*. Zaten është pjesë e pandashme e funksionit të gjykatës që t’i njohë ligjin. Kjo nuk është e kufizuar vetëm në fushën e ligjit penal por edhe në fushat e tjera.

33. Në lëndën në fjalë, nga **H. S.** është kërkuar të analizojë nëse vendimet e **L. R.** ishin në përputhshmëri me ligjin. Kjo nuk është vërtetim faktik por është tërësisht vërtetim ligjor, asi që doemos bëhet dhe mund të bëhet vetëm nga trupi gjyqës.

34. Më tej, nga **H. S.** është kërkuar në mënyrë efektive të përcaktoj përgjegjësinë penale të të akuzuarve. Vetëm trupi gjykues mund të vlerësoj “treguesit” nëse **L. R.** dinte për zbatimin e gabueshëm të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës dhe nëse drejtori gjeneral mban përgjegjësi ligjore për vendimet e marra në vitin 2008. Në të vërtetë, këto çështje shtrihen në mes të procedurës penale, dhe asnjë ekspert nuk mund të angazhohet për t’i deklaruar apo për t’i ofruar trupit gjykues udhëzime për ta. Këto duhet të përcaktohen nga trupi gjykues pas një analize të kujdesshme të të gjitha provave.

35. Prandaj Gjykata e Apelit konsideron se analizës ligjore të bërë nga **H. S.** me të drejtë nuk i është dhënë statusi i provës së ekspertit.⁶ Marrja në pyetje e dëshmitarit në cilësinë e ekspertit për këto pyetje ishte ose do të ishte njëjtë jo e duhur. Dëshmitari ndoshta mund të dëshmojë për përvojën e tij në raste të ngjashme, praktikat dhe procedurat e zakonshme të miratuara në trajtimin e rasteve të tilla por asgjë më shumë se kjo.

36. Si konkluzion, Gjykata e Apelit konsideron se nuk mund të jepet asnjë raport apo dëshmi e ekspertit për interpretimet ligjore të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës sikurse kishte kërkuar prokurori në këtë lëndë. Një interpretim i tillë mund të bëhet vetëm nga trupi gjykues me synimin për të përcaktuar nëse interpretimi i miratuar nga të akuzuarit ishte i atij lloji sa për të arritur në shpërdorimin e pozitës zyrtare apo autorizimit. Çështje ka të bëjë me interpretimin ligjor dhe jo vërtetimin faktik të natyrës teknike i cili do të kërkonte dhe në fakt, lejonte asistimin e një eksperti sipas nenit 236 të KPPK-së.

37. Prandaj këtu nuk ka pasur shkelje të neneve 236 dhe 237 të KPPK-së.

38. Në pjesën ku ka të bëjë me shkelje të supozuar të nenit 363 paragrafi (1) të KPPK-së, Gjykata e Apelit vëren se prokurori special në ankesën e tij nuk ka specifikuar se cilat pyetje konkretisht ai është penguar t’i parashtrij nëse trupi gjykues nuk do t’i kufizonte pyetjet për të qartësuar intervistimin. Në secilin rast, gjykata konsideron se dëshmia e **H. S.** nuk mund të konsiderohet dëshmi e ekspertit mbi interpretimin ligjor sikurse u shtjellua më lart. Gjykata e Apelit vë në dukje se nuk ka bazë për të besuar se shkelja e pretenduar e nenit 363 paragrafi (1) të KPPK-së do të kishte ose do të mund të kishte ndikim në nxjerrjen e një aktgjykimi të ligjshëm dhe të duhur në lëndë. Në esencë, ndonëse trajtimi i provave nga ana e trupit gjykues gjatë procedurës ishte konfuz dhe kontradiktor, vendimi përfundimtar i kolegjit për të mos i dhënë peshë kësaj prove, sipas këndvështrimit të gjykatës, është i drejtë. Gjykata e Apelit megjithatë rithekson se prapë se prapë ka qenë obligim i trupit gjykues që të shtjelloj pse nuk ka marrë parasysh këtë provë dhe sipas rregullit të sqaroj qëndrimin e saj në vend që të linte palët të hamendeshin. Në këtë drejtim, arsyetimi i trupit gjykues ishte mjaft i pakënaqshëm.

Shkelje e supozuar e nenit 360 paragrafi (1) të KPPK-së

⁶ Gjykata e Apelit vëren se në renditjen e provave të administruara në gjykim, në faqen 5 të aktgjykimit të kundërshtuar (versioni në gjuhën angleze) raporti ishte emërtuar “raporti i ekspertit”. Megjithatë nga arsyetimi është e qartë, në veçanti, në faqet nga 9 deri në 12, se trupi gjykues pranoi analizën ligjore vetëm si provë të dokumentuar e jo si provë të ekspertit.

39. Prokurori special parqet se refuzimi i trupit gjykues për të dëgjuar **B. S.** si dëshmitar rezultoi në shkelje të të drejtës së prokurorisë për të paraqitur prova, të rëndësishme për një gjykim korrekt dhe të drejtë sipas nenit 360 paragrafi (1) të KPPK-së. Prokurori argumenton se dëgjimi i dëshmitarit **B. S.** ishte thelbësor për lëndën pasi që dëshmitari në një raport të brendshëm të auditimit theksoi se vendimet e marra nga **L. R.** haptazi kanë shkelur ligjin dhe interpretimet e tij të ligjit ishte të njëanshme. Për më tepër dëshmia e tij ka mundur të vërtetohet gjetjet e **H. S.**

40. Trupi gjykues refuzoi propozimin e prokurorit special për të thirrur **B. S.** si dëshmitar me aktvendimin me shkrim të datës 18.04.2012. Trupi gjykues pohoi se duke bërë një analizë profesionale mbi ligjshmërinë e vendimeve të marra nga njëri prej të akuzuarve, e bën atë më tepër një ekspert të mundshëm sesa dëshmitar dhe se dëshmitarët u thirrën të sqarojnë faktet dhe jo raportet nga ekspertët e tjerë. Kolegji po ashtu konsideroi se çështja është rreptësisht ligjore. Gjykata e Apelit pajtohet me gjetjet e trupit gjykues se marrja në pyetje e dëshmitarit **B. S.** nuk ishte relevante për vërtetim të drejtë dhe të plotë të lëndës.

41. Trupi gjykues me të drejtë ka vënë në pah në aktgjykimin e kundërshtuar, se pavarësisht asaj nëse vendimet e **L. R.** u konsideruan apo nuk u konsideruan të ligjshme nga kolegët e tij dhe/ose auditorët, kjo në vetvete nuk do të thotë se ato u motivuan ose u ndikuan nga arsye politike.

42. Prokuroria në lëndë ka treguar se interpretimi i **L. R.** i neneve 237 dhe 241 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës u kontestua nga kolegët e tij dhe ekspertët e tjerë. Në këtë procedurë penale megjithatë nuk është çështja nëse interpretimit i kodit nga **L. R.** ishte apo nuk ishte përfundimisht i drejtë; çështja është nëse ka prova me të cilat provohet se **L. R.** miratoi një interpretim të gabueshëm me dashje për shkak të një lloj motivimi politik dhe më e rëndësishmja, këtë e ka bërë për të shkaktuar dobi apo dëm pasuror. Këto janë elemente kyçe të akuzës *penale* kundër tij.

43. Prokurori special kurrë nuk ka pohuar se dëshmitari **B. S.** kishte ndonjë njohuri apo ishte dëshmitar i ndonjë motivimi politik të ushtruar mbi **L. R.**. Në vend të kësaj, dëshmitarit **B. S.** i ishte propozuar të dëshmonte mbi 'ligjshmërinë e vendimeve të **L. R.**. Gjykata e Apelit prandaj konstaton se dëshmia e dëshmitarit **B. S.** nuk ka mundur të ketë asnjë ndikim në epilogun e procedurës dhe se trupi gjykues me të drejtë ka refuzuar kërkesën për ta dëgjuar këtë dëshmitar.

44. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 360, par. (1) të KPPK-së dhe rrjedhimisht as shkelje të nenit 403, par. (2) të KPPK-së.

Shkelja e pohuar e nenit 360, par. (5) të KPPK-së

45. Prokurori special lidhur me bazën ankimore të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike pohon se trupi gjykues kishte shkelur nenin 360, par. (5) të KPPK-së duke mos e thirrur **A. Sh.** si dëshmitar, duke shfrytëzuar kompetencat e veta *ex officio*. Edhe pse e konstatuar si bazë tjetër ankimore, parashtrësia në fjalë pohon shkeljen e procedurës penale dhe e njëjta do të adresohet brenda së njëjtës temë.

46. Dëshmitari **A. Sh.** së pari është propozuar si dëshmitar nga ana e mbrojtjes por ky propozim më vonë është tërhequr në gjykim të hapur. Prokurori nuk ka propozuar që **A. Sh.** të ftohet si dëshmitar, bile as pas tërheqjes së propozimit të mbrojtjes.

47. Trupi gjykues në bazë të nenit 360, par. (5) të KPPK-së ka trupi gjykues ka të drejtë të shqyrtojë provën që e konsideron *të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale.*⁷ Në lëndën në fjalë, në të cilën **A. Sh.** ka qenë dëshmitar i rëndësishëm i cili do të mund të dëshmonte lidhur me ndikimin e pohuar politik, do të ishte e preferuar që trupi gjykues do ta thërriste si dëshmitar. Ai ishte zaten personi për të cilin është pohuar të ketë ushtruar presion politik mbi të akuzuarin. Duke i përmendur këto, mos thirrja e dëshmitarit, megjithatë nuk arrin shkallën e shkeljes së nenit 360, par. (5) të KPPK-së.

48. Prokurori përfaqëson aktakuzën para gjykatës dhe ka për detyrë të prezantojë dhe të propozojë provat të cilat ai / ajo i konsideron të rëndësishme për procedurën penale. Prokurori nuk mund të heq dorë nga detyrimi i vet për të propozuar prova duke u mbështetur në shfrytëzimin e kompetencave *ex officio* të trupit gjykues, në bazë të nenit 360, par. (5) të KPPK-së. Ose në qoftë se prokurori bën një gjë të tillë, atëherë nuk do të mund të mbronte me sukses se ishin mbledhur prova të caktuara të cilat ai nuk i kishte propozuar kurrë.

49. Gjithashtu pretendimi se për shkak të faktit se nuk është dëgjuar dëshmitari kemi vërtetim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, është i pabazë. Prokurori nuk paraqet asnjë argument kuptimplotë i cili do të mbështeste konstatimin se dëshmitari do të kishte dëshmuar në atë mënyrë e cila do të çonte tek një vërtetim i ndryshëm i gjendjes faktike. Përkundrazi, vetë prokurori e bën me sa duket këtë të ditur në dëshminë e vet “**A. Sh.** do të kishte pretenduar se nuk ushtruar ndikimin e vet politik në procesin e vendimmarrjes”.⁸

50. Nuk ka pasur shkelje të nenit 360, par. (5) të KPPK-së dhe nga kjo rrjedh se nuk kemi të bëjmë me vërtetim të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike.

IV. B. Shkelja e pohuar e ligjit penal sipas nenit 404 të KPPK-së

51. Prokurori special pohon se aktgjykimi i kundërshtuar shkel ligjin penal për arsye se keqinterpreton çështjet preliminare në ligjin administrativ dhe në ligjin mbi doganat dhe si pasojë e kësaj bën një interpretim të gabuar të Kodit të Kosovës mbi doganat dhe akcizën.

52. Argumentet në të cilat është thirrur bëjnë pjesë në kuadër të bazës ankimore të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe jo shkeljes së ligjit penal. Vërtetimi i asaj nëse i akuzuari ashiqare dhe me dijeni të plotë ka shkelur kodin mbi doganat dhe akcizën e Kosovës është pjesë e vërtetimit faktik dhe jo vërtetim i ligjit penal. Të sfiduarit e aktgjykimit të

⁷ Shih po ashtu nenin 7, par. (1) të KPPK-së.

⁸ Ankesa, faqe 14 (versioni në gjuhën angleze).

kundërshtuar duke u bazuar në një shkelje të ligjit penal kufizohet në keq zbatimin apo lëshimin për të zbatuar *normat e ligjit penal*, siç përcaktohet me nenin 404 të KPPK-së.

53. Në lëndën në fjalë çështja nëse vendimi i marrë nga **L. R.** për të lejuar vazhdimin e importimit të mëtejshëm të duhanit ka qenë në kundërshtim me çfarëdo arsytimi ligjor, është çështje kyçe në procedurën penale e cila po zhvillohet ndaj tij. Edhe pse vërtetimi i çështjes në fjalë ka të bëjë me interpretimin ligjor i cili ka të bëjë me ligjet e doganës dhe me ligjin administrativ, i njëjti vazhdon të mbetet vërtetim faktik i cili ka të bëjë me procedurën përkatëse penale.

54. Gjykata e Apelit prandaj do t'i adresojë argumentet e prokurorisë në pjesën në vazhdim me titullin vërtetimi i pohuar i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike.

IV. C. Vërtetimi i pohuar i gabueshëm ose jo i plotë i gjendjes faktike

55. Prokurori special pohon se arsytimi me gojë i dhënë pas shpalljes së aktgjykimit si dhe aktgjykimi me shkrim kanë dallime në mes vete rreth asaj nëse ka pasur ndikim politik të ushtruar mbi **L. R.**

56. Gjykata e Apelit vë në pah formulimin e dykuptimshëm të arsytimit me gojë të dhënë nga ana e kryetarit të kolegjit më 17 maj 2012, kur kryetari i kolegjit duket se ka deklaruar se ky vendim është “nxitur për qëllime të tjera jo ligjore”.⁹ Megjithatë, të lexuarit e arsytimit me gojë si tërësi korrespondon me gjetjet e shtjelluara në aktgjykimin me shkrim. Kryetari i trupit gjykues ka sqaruar se trupi gjykues kishte dyshime lidhur me atë nëse **L. R.** e dinte se vendimi në fjalë ishte ligjërish i gabueshëm apo jo. Kryetari i kolegjit në mënyrë specifike ka përmendur si të rëndësishme për një përfundim të këtillë se **L. R.** ishte pajtuar me interpretimin e njëjtë (tash të kontestuar) të Kodit mbi doganat dhe akcizën *para se* të takoheshin **N. H.** dhe ... **A. Sh.** me njëri tjetrin. Duke e lexuar këtë arsytim si tërësi, duket se kolegji ka konstatuar se prokuroria nuk ka arritur të provojë përtej dyshimit të arsyeshëm se ndikimi politik është ushtruar mbi **L. R.** Kolegji kishte vënë në pah se kishte dyshime lidhur me gjendjen faktike dhe se i kishte zgjidhur këto dyshime në përputhje me ligjin, në të mirë të të akuzuarit. Arsytimi me gojë si tërësi prandaj korrespondon me gjetjet në aktgjykimin e arsytuar. Në këtë të fundit, trupi gjykues ka shtjelluar lidhur me atë se cilat elemente të veprës penale nuk i ka konsideruar të provuara. Kolegji ka arsytuar se janë prezantuar prova të pamjaftueshme për të konstatuar përtej dyshimit të arsyeshëm se interpretimi i **L. R.** ka qenë pa ndonjë arsytim të shëndoshë dhe se mungonte lidhja subjektive në mes të veprimit të pohuar të keqpërdorimit të pozitës ose autorizimit dhe shkakimit të dëmit apo të përfitimit të kundërligjshëm.

57. Prokurorja e shtetit e apelit në mendimin e vet thekson mospërputhjen e perceptuar në aktgjykimin e arsytuar. E njëjta sugjeron se kolegji nga njëra anë shkruan se si disa fakte mund të nënkuptojnë një dyshim të fuqishëm se vendimet e z. **L. R.** kanë qenë të ndikuara politikisht

⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 17.05.2012, faqe 2 (versioni në gjuhën angleze).

përderisa nga ana tjetër kolegji gjen se nuk ka prova se vendimet kanë qenë të mbështetura në ndërhyrjet politike. Gjykata e Apelit nuk i konsideron këtë gjetje kontradiktore me njëra tjetrën të cilat e përjashtojnë njëra tjetrën. Trupi gjykues zaten ka konsideruar se ka prova të mjaftueshme për të treguar dyshimin e ndikimit politik por në të njëjtën kohë ka gjetur se ato prova nuk kanë arritur të konstatojnë përtej dyshimit të arsyeshëm se një ndikim i tillë ishte ushtruar.

58. Prokurori special argumenton se gjetjet faktike të trupit gjykues janë të mbështetura në vlerësimin jo të plotë të provave. I njëjti sugjeron se kolegji nuk ka marrë parasysh këto prova vendimtare: deklaratat e dëshmitarëve **J.H.**, **Xh.P.** dhe **Sh.B.**, dëshminë e ekspertit **H.S.**, raportin mbi auditimin e brendshëm të **B. S.**, korrespondencën përmes postës elektronike të zhvilluar në mes të **N. H.** dhe **L. R.** si dhe në mes të **L. R.** dhe Besim Currit më 26 dhjetor 2008, provat rrethore të propozuara nga prokuroria. Prokurori special po ashtu pretendon se trupi gjykues nuk ka arritur të sigurojë kundër raportin e ekspertit në rast se mendimi i ekspertit **H.S.** ishte konsideruar i dyshimtë.

59. Gjykata e Apelit pajtohet me prokurorin special se trupi gjykues nuk ka arritur të adresojë disa prej provave me rëndësi në këtë lëndë. Përderisa trupi gjykues nuk është obliguar të diskutonte secilën provë veç e veç, i njëjti është dashur të adresojë në mënyrë më të detajuar rëndësinë dhe vlerën provuese të dëshmive të dëshmitarëve dhe të provave të dokumentuara të prezantuara gjatë shqyrtimit gjyqësor me qëllim që të arsyetojë gjetjet e veta sa më qartë dhe sa më hollësisht.

60. Edhe pse ky arsyetim i trupit gjykues nuk është i përsosur, Gjykata e Apelit vë në pah se arsyetimi i pamjaftueshëm nuk është i atillë saqë të arrijë shkallën e shkeljes së nenit 403, par. (1), pikës 12 të KPPK-së. Trupi gjykues zaten ka theksuar në mënyrë specifike se cilat fakte i kishte konsideruar të provuara dhe cilat jo dhe se nuk ka mospërputhje brenda për brenda arsyetimit të kolegjit.

61. Gjykata e Apelit pajtohet me gjetjet e trupit gjykues lidhur me faktet vendimtare, siç do të diskutohet më hollësisht në vazhdim. Pas vlerësimit të kujdesshëm të provave të referuara në ankesën e prokurorisë, qofshin ato një nga një apo si tërësi, provat në fjalë as nuk dëmtojnë as nuk kundërshtojnë gjetjet e trupit gjykues.

62. **J. H.** ka dëshmuar se **L. R.** ka kërkuar të takohej me të gjatë periudhës qershor – gusht 2010. Ky dëshmitar ka dëshmuar se **L. R.** i kishte thënë se po flitej kundër tij dhe se kjo kishte të bënte me faktin se i njëjti ishte në garë për postin e drejtorit të doganës. Ai – **L. R.**, në këtë mënyrë kishte dëshirë ta dëgjonte mendimin profesional të **J. H.** lidhur me interpretimin të cilin e kishte miratuar.¹⁰

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 18.04.2012, faqet 3 - 5 (versioni në gjuhën angleze)

63. Sugjerimi i prokurorit është se veprimet e **L. R.** janë tregues i “mendjes fajtoare – mizës nën kapuç” të kryerësit i cili po merrte masat parandaluese për mos t’u kapur. Gjykata e Apelit e refuzon një argument të këtillë si të pabazë.

64. Vepra penale në fjalë është kryer në vitin 2008, përderisa **L. R.** kishte kontaktuar **J. H.** më shumë se dy vjet më vonë, zaten në verën e vitit 2010. Ky dëshmitar ka shtjelluar se **L. R.** kërkonte mendimin e tij profesional për shkak se ishte duke garuar për atë pozitë dhe se vendimet të cilat i kishte marrë po shfrytëzoheshin kundër vetes së tij. Shpjegimi në fjalë duket i arsyeshëm dhe i besueshëm. **L. R.** kishte kontaktuar personin **J. H.** për një vlerësim profesional dhe nuk e dinte se çfarë vlerësimi do të ishte ai. Po të kishte bërë vërtet përpjekje për ndërmarrjen e masave parandaluese për t’u mos kapur, siç sugjeron prokuroria, **L. R.** me siguri se do të kishte kërkuar mendimin e një personi për të cilin paraprakisht do ta dinte se do të pajtohej me interpretimin e tij. Në vend të kësaj, ai kishte kërkuar mendimin e një eksperti ndërkombëtar të EULEX-it, pa e ditur se çfarë do të ishte mendimi i tij. Për këtë arsye, kërkimi nga ana e **L. R.** i mendimit të ekspertit **J. H.**, prandaj sipas pikëpamjes së gjykatës nuk nxjerr në pah asnjë send që ka të bëjë me siç pretendohet *mens rea* të këtij të akuzuari.

65. Ndërkaq kur kemi të bëjmë me dëshminë e dhënë nga **Xh. P.**, ky dëshmitar ka dëshmuar rreth asaj se çfarë kishte dëgjuar të kenë thënë **N. H.** dhe Besim Curri lidhur me **L. R.**, konkretisht rreth asaj se si **L. R.** nuk është i prirë për të vepruar në përputhje me ligjin. Ky dëshmitar prandaj nuk ka dëshmuar nga njohuritë e veta rreth veprimeve apo sjelljes së **L. R.**, por nga ajo çfarë ka dëgjuar prej personave të tretë, njëri prej tyre i bashkakuzuar në këtë lëndë. Për më tepër, dëshmitari **Xh. P.**, nuk kishte thënë se ndonjë prej komenteve të këtilla lidhur me të akuzuarin **Rafuna** madje as nuk ishte bërë në raport me vendimet të cilat nxitën këtë procedurë penale, por në fakt ishin të përgjithësuara. Po ashtu vlen të përmendet se **N. H.** në dëshminë e vet kishte deklaruar se kurrë nuk kishte qenë i pakënaqur me **L. R.** qoftë në planin profesional apo në atë etik dhe po të mos kishte qenë kështu nuk do ta kishte mbajtur më gjatë.¹¹ Dëshmia e **Xh. P.**, në këtë mënyrë nuk është asgjë më tepër se një dëshmi e dëshmitarit që dëshmon për thashetheme. Prova të tilla nuk kanë vlerë provuese në procedurën penale në fjalë dhe me të drejtë nuk kanë çuar peshë për trupin gjykues.

66. Prokurori në ankesën e vet po ashtu i referohet provave të dhëna nga dëshmitari **Sh.B.**. Prokurori special në ankesën në fjalë, për arsye të panjohura i referohet deklaratës së dëshmitarit gjatë procedurës paraprake, në vend se t’i referohej dëshmisë së tij gjatë shqyrtimit gjyqësor. Çka është më me rëndësi, Gjykata e Apelit nuk arrin të kuptojë se si një dëshmi e marrë nga një dëshmitar i tillë mund t’i ndihmojë ndjekjes penale të kësaj lënde.

67. E para, shihet se dëshmia e dëshmitarit **Sh.B** ka qenë konsekuente si në hetime ashtu edhe para trupit gjykues. Ky dëshmitar ka dëshmuar se ...**A. Sh.** – me sa di ai – ka kërkuar të gjejë një rrugë ligjore, një zgjidhje ligjore nëse ekzistonte një e tillë. Dëshmia e tij nuk e mbështet

¹¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 24.04.2012, faqe 7.

ndjekjen penale të ndërhyrjes politike në këtë lëndë. Dëshmitari nuk ka dëshmuar se ministri kishte kërkuar marrjen e një vendimi të caktuar. Në të kundërtën, në bazë të dëshmitarit **Sh.B.**, ministri vetëm e kishte inkurajuar **N. H.** të gjente një zgjidhje ligjore.

68. Dëshmia e dëshmitarit **H.S.** dhe analiza e tij ligjore nuk adresohet në aktgjykimin e kundërshtuar, edhe pse e njëjta mund të argumentohet se përbënte pjesën qendrore të ndjekjes së lëndës nga prokuroria. Më lart është adresuar konfuzioni të cilit e kishte krijuar trupi gjykues me mënyrën në të cilën kishte trajtuar statusin e këtyre provave.

69. Trupi gjykues nuk ka diskutuar përmbajtjen aktuale të provave të dokumentuara. Pavarësisht një lëshimi të tillë, Gjykata e Apelit vë në pah se trajtimi i kësaj prove nga ana e trupit gjykues mund të nxirret nga pozita e tij lidhur me interpretimin ligjor të kodit mbi doganat dhe akcizën, të kryer nga **L. R.** Trupi gjykues në aktvendimin e kundërshtuar diskuton këto dy interpretime të kundërta dhe vjen në përfundim se interpretimi kufizues i **L. R.** lidhur me nenin 237 të kodit në fjalë nuk mund të konsiderohet si interpretim “pa asnjë bazë të shëndoshë ligjore”. Është e qartë po ashtu nga aktgjykimi i kundërshtuar se trupi gjykues, goxha drejt, ka marrë mbi supet e veta rishikimin e arsytimit të interpretimit ligjor. Kolegji shkruan se “nuk është detyrë e këtij kolegji që të krijojë jurisprudencë mbi dispozitat ligjore administrative apo të certifikojë interpretimet e drejta dhe të gabueshme. Detyrë e kolegjit është të vërtetojë nëse vendimet në fjalë janë marrë pa asnjë arsyetim të shëndoshë ligjor siç pohohet në aktakuzë dhe, nëse ky është rasti, një gjë e tillë ka ndodhur përtej dyshimit të arsyeshëm. Megjithatë, [...] kjo gjykatë nuk mund ta përkufizojë interpretimin e bërë nga **L. R.** si *pa asnjë arsyetim të shëndoshë ligjor* dhe si *përtej dyshimit të arsyeshëm*”.¹²

70. Gjykata e Apelit gjen se vendimi i trupit gjykues për mos t’i dhënë asnjë lloj peshe kësaj prove ishte një vendim i drejtë. Trupi gjykues me të drejtë ka mbajtur pikëpamjen se është detyrë e tyre të vlerësojnë nëse **L. R.** me dashje kishte ndjekur një interpretim ligjor ashiqare të gabueshëm apo jo.

71. Sidoqoftë, siç është theksuar më lart, trupi gjykues është dashur të diskutojë arsyen *pse* nuk e ka marrë parasysh këtë provë. Trupi gjykues ka konsideruar se ka prova të mjaftueshme për të sugjeruar se interpretimi i **L. R.** është “*pa asnjë arsyetim të shëndoshë ligjor dhe përtej dyshimit të arsyeshëm*”. Trupi gjykues po ashtu ka konstatuar se ka prova të pamjaftueshme për të sugjeruar se **L. R.** kishte zgjedhur një interpretim ligjor të gabueshëm duke e ditur se ky lloj interpretimi është i kundërligjshëm. Trupi gjykues i ka dhënë rëndësi specifike faktit se **L. R.** kishte mbrojtur të njëjtin interpretim para marrjes së çfarëdo vendimi konkret, si dhe kishte shfaqur në mënyrë publike një mendim të këtillë. Interpretimi i **L. R.** mund të perceptohet se nuk është në përputhje me ligjin nga ana e kolegëve të tij, megjithatë, për sa kohë që ai kishte besuar se një interpretim i tillë ishte i drejtë, nuk bëhet fjalë për vepër penale. Është pjesë e pandashme e ligjit që më shpesh të kemi interpretime të ndryshme sesa të njëjta. Nganjëherë vendimet mund të

¹² Aktgjykimi i kundërshtuar faqet 17 - 18 (versioni në gjuhën angleze).

konsiderohen të kundërligjshme lidhur me vazhdimin e procedurës, por një gjë e tillë vetvetiu nuk do të thotë se është kryer një vepër penale.

72. Vetë perceptimi mbi vendimet e kundërligjshme nuk mund të qëndrojë si provë për sjelljen penale. Çdo gjetje e tillë duhet domosdo të bazohet në prova bindëse apo vendimtare me të cilat tregohet se i akuzuari ka qenë në dijeni mbi kundërligjshmërinë. Në lëndën në fjalë këto prova vendimtare mungojnë.

73. Prokurori special në ankesë po ashtu i referohet raportit të auditimit të brendshëm të **B. S.**, i cili i konsideronte interpretimet e **L. R.** si të “njëanshme”.

74. Edhe një herë, Gjykata e Apelit vë në pah se janë të qarta mospërputhjet e interpretimeve. Po ashtu është e qartë se shumica dërmuese e kolegëve të **L. R.** dhe e kolegëve ekspertë nuk kishin mbështetur interpretimin ligjor të tij duke e konsideruar të njëjtin të pasaktë.

75. Prokurori më tej i kushton shumë rëndësi shkëmbimit të porosive përmes postës elektronike më 26 dhjetor 2008 në mes të **N. H.** dhe **L. R.**. Prokurori thekson se këto porosi tregojnë një sjellje të planifikuar paraprakisht të **L. R.** e cila demonstroi kushtin e nevojshëm *mens rea*.¹³ Gjykata e Apelit refuzon argumentin e prokurorit dhe gjen se një përfundim i tillë mund të arrihet vetëm duke u bazuar në tekstin dhe kohën e dërgimit të këtyre porosive. Po ashtu duhet të theksohet se **N. H.** ka dëshmuar se së pari e kishte autorizuar me gojë **L. R.** e pastaj i kishte dërguar të njëjtit edhe e-mail lidhur me këtë.¹⁴

76. Prokurori special pajtohet se shumica e provave ndaj dy të akuzuarve janë prova rrethore.

77. Gjykata e Apelit e pranon se trupi gjykues nuk ka shqyrtuar provat rrethore në të cilat është mbështetur prokurori dhe nuk i ka komentuar të njëjtat në mënyrë kuptimplote. Megjithatë, vlera provuese e provave të cilat i ka përmendur prokurori në fjalën e vet përfundimtare dhe tash të përmbledhura në ankesë është e shkallës së ulët dhe nuk arrin standardin e nevojshëm për dënim, madje edhe kur të merret si tërësi.

78. Shpallja fajtor e bazuar kryesisht në prova rrethore sipas ligjit nuk është e palejuar, përderisa gjykata është e aftë të konstatojë, duke u mbështetur në të gjitha provat rrethore të prezantuara, se një fakt provohet përtej dyshimit të arsyeshëm. Është pjesë e pandashme kur bëhet fjalë për provat rrethore se më shumë se një shpjegim është i mundshëm, dhe se gjykata, për të shpallur dikë fajtor duke u bazuar në prova rrethore, duhet domosdo të bindet se një konkluzion i caktuar i mbizotëron të gjithë të tjerët. Tërësia e provave rrethore në lëndën në fjalë nuk i mundëson gjykatës të dyshojë rreth vendimit të trupit gjykues.

¹³ Ankesa, faqet 10 - 11 (versioni në gjuhën angleze)

¹⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, seanca e datës 24.04.2012, faqe 10 (versioni në gjuhën angleze).

79. Prokurori po ashtu parashtroi se aktgjykimi i kundërshtuar gabimisht ka interpretuar dispozitat fillestare ligjore të ligjit mbi doganat dhe të ligjit administrativ.

80. Gjykata e Apelit tashmë ka shpallur si të drejtë qasjen e trupit gjykues që vetë të interpretojë Kodin mbi doganat dhe akcizën. Gjykata e Apelit po ashtu ka vërtetuar gjetjen e kolegjit se nuk ka prova të mjaftueshme për të konstatuar se **L. R.** ka zgjedhur interpretimin të cilit e kishte zgjedhur duke e ditur se i njëjti ishte i kundërligjshëm. Ankesa po ashtu shtjellon çështjen lidhur me delegimin e perceptuar si të gabueshëm të kompetencave administrative nga **N. H.** dhe mos marrjen parasysh të parimeve administrative.

81. Delegimi i autorizimit nga **N. H.** tek **L. R.** është kundërshtuar nga prokuroria dhe është pohuar të jetë tregues i dashjes së të akuzuarit për të vepruar kundërligjshëm. Gjykata nuk pajtohet me një gjetje të këtillë. Duke lënë anash çështjen nëse emërimi përmes postës elektronike ka qenë në përputhje me procedurën administrative apo jo, **N.H.** ka dhënë një sqarim të arsyeshëm lidhur me arsyen pse delegimi ka ndodhur në këtë formë – kjo u bë për shkak se i njëjti aso kohe gjendej në Zvicër për pushime. Duhet të përmendet se kjo letër përmes postës elektronike nuk i është dërguar vetëm **L. R.** porse një kopje e saj i është dërguar edhe **Bajram Rexhës**. Pra, nuk ka pasur asnjë përpjekje për të fshehur emërimin në fjalë dhe ky emërim është bërë në mënyrë transparente. Përderisa delegimi në mospërputhje me ligjin administrativ do të kishte implikime për vlefshmërinë e vendimeve të nxjerra administrative të cilat pastaj për këtë arsye do të mund të kundërshtoheshin në procedurë përkatëse, e njëjta nuk ka ndikim në këtë procedurë penale.

82. Gjykata e Apelit nuk ka nevojë që të vlerësojë pohimet mbi shkeljet e ligjeve administrative. Kjo procedurë nuk është procedurë administrative për shqyrtimin e vendimeve administrative të marra. Kjo është procedurë penale me të cilën pohohet përgjegjësia penale e të akuzuarit për vendimet e nxjerra sipas nenit 339, par. (1) deri në (3) të KPK-së.

83. Në përfundim, lidhur me pohimin e prokurorit për vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, nuk ka shkelje të tilla. Trupi gjykues drejt ka vërtetuar faktet vendimtare dhe ka gjetur se nuk janë prezantuar prova të mjaftueshme për të konstatuar se ato fakte vendimtare janë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

84. Gjykata e Apelit vëren se përderisa ankesa në fjalë është e përqendruar në gjetjet e trupit gjykues të cilat nuk janë provuar gjoja se i akuzuari me qëllim ka shkelur ligjin, nuk ka argument kuptimplotë i cili do të hidhte poshtë konkluzionin e kolegjit se po ashtu nuk është provuar as fakti që i akuzuari ka vepruar me dashje për të shkaktuar dëm apo përfitim material.

V. Rishikimi Ex officio

85. Trupi gjykues në fjalinë e parë të dispozitivit gabimisht i është referuar nenit 390, par. (2) të KPPK-së në vend se t'i referohej nenit 390, par. (3) të KPPK-së. Është e qartë nga leximi i aktgjykimit të kundërshtuar si tërësi, në veçanti i arsytimit, se trupi gjykues ka liruar të

akuzuarin për shkak të mungesës së provave në këtë lëndë. Kolegji askund nuk ka diskutuar arsyet për përjashtimin e përgjegjësive penale të të akuzuarit, të cilës i referohet neni 390 (2) i KPPK-së. Çështja e përjashtimit të përgjegjësive penale do të dilte në pah vetëm në qoftë se i akuzuari do të ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale, siç përcaktohet me nenin 10 të KPK-së. Gjykata e Apelit konsideron se referimi i paragrafit të gabuar në dispozitivin e aktgjykimit të kundërshtuar është vetëm një gabim shtypi. Me qëllim të qartësisë së plotë, ky gabim i shtypit korrigjohet duke bërë ndryshimin e dispozitivit.

86. Kolegji ka urdhëruar që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga burimet buxhetore. Trupi gjykues megjithatë si bazë ligjore gabimisht ka përmendur nenin 103, par. (3) të KPPK-së, në vend se t'i referohej neni 103, par. (1) të KPPK-së. Paragrafi (3) zaten i referohet detyrimit të paditësit privat dhe paditësit subsidiar për t'i paguar shpenzimet në fjalë në rast të lirimit, përderisa par. (1) korrespondon me vendimin në fjalë të marrë nga trupi gjykues. Gjykata e Apelit ka korrigjuar këtë referencë të gabuar.

87. Gjykata e Apelit nuk gjen asnjë shkelje sipas neni 415 (1) të KPPK-së.

88. Prandaj vendoset si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë të autorizuar.

Aktgjykimi i arsyetuar është përfunduar më 16 shtator 2013.

Kryetarja e kolegjit

Hajnalka Veronika Karpati

Gjyqtare e EULEX-it

Anëtari i kolegjit

Anëtari i kolegjit

Procesmbajtësja

Xhevdet Abazi

Fillim Skoro

Beti Hohler

Gjyqtar

Gjyqtar
EULEX-it

Zyrtare ligjore e

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Pakr 1123/12
27 gusht 2013